



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-113
Prishtinë, më 20 korrik 2010, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 20 KORRIK 2010

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Naim Maloku, Nexhat Daci, Sllobodan Petroviq dhe Etem Arifi, anëtarë të Kryesisë;

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Ismet Beqiri, Ibrahim Makolli dhe Xhezair Murati.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi dhe Skënder Reçica.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Xheladin Hoxha, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e Presidentit: Lumnije Murati,
Nga ZCN: Blerta Bejtullahu,
Nga OSBE: Lejla Selimi dhe
Nga NDI, Shefki Kastarti.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe pesë pika shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, miratoi këtë:

R e n d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 13 korrik 2010,
2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 13 korrik 2010

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 13 korrik 2010, u miratuar pa vërejtje.

2. Konfirmimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare, më 22 korrik 2010

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja e Kuvendit të mbahet më 22 korrik 2010, me këtë

R e n d i t e:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për gjykatat,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Avokatin e Popullit,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për grevat,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Inspektoratin e tregut dhe mbikëqyrjen inspektuese,
10. Shqyrtimi i Raportit të punës të Avokatit të Popullit, për vitin 2009,
11. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit, për vitin 2009,
12. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Institutit Gjyqësorë të Kosovës, për vitin 2009,
13. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare të Kompanisë së ujësjellësit rajonal "Prishtina", për vitin 2009,

14. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin 2009,
15. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve , për vitin 2009,
16. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Programin Kombëtar të Shkencës,
17. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me pasqyrat e audituara të Trustit të Kursimeve Pensionale, për vitin 2009.
18. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe të anëtarëve të Bordit të Agjencisë së Privatizimit.

Kryesia, gjithashtu, vendosi që Kuvendi të mbaj edhe një mbledhje tjetër plenare, pas dhënies së opinionit nga GjND lidhur me shpalljen e pavarësisë së Kosovës, të hënë, më 26 korrik 2010, për të miratuar një Deklaratë lidhur me opinionin e GjND-së. Si pikë e dytë e kësaj mbledhje të jetë: Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Propozimin e Strategjisë për privatizimin e PTK-së.

3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave

3.1 Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Emrush Xhemajli për ta ftuar në interpelancë kryeministrin e Kosovës, Hashim Thaçi

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e deputetit Emrush Xhemajli për ta ftuar në interpelancë kryeministrin e Kosovës, Hashim Thaçi, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkesa e deputetit Emrush Xhemajli, për ta ftuar në interpelancë kryeministrin e Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, të radhitet në rend dite të mbledhjes së parë plenare, të sesionit vjeshtor.

3.2 Shqyrtimi i propozimit të Komisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit lidhur me aspektet e funksionimit të Kuvendit, sipas Rregullores së re të Kuvendit

Kryesia, pasi shqyrtoi propozimin e Komisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit lidhur me aspektet e funksionimit të Kuvendit, sipas Rregullores së re të Kuvendit, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Dhënia e betimit të deputetit, në pajtim me nenin 10 të Rregullores së Kuvendit, të aplikohet për deputetët, që do të zëvendësohen në të ardhmen.
2. Zhvendosja e kohës për deklarime jashtë rendit të ditës dhe për pyetje parlamentare do të shqyrtohet në sesionin vjeshtor.

3.3 Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar të SLS-së për formimin e Komisionit Legjislativ–Gjuhësor

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e Grupit Parlamentar të SLS-së për formimin e Komisionit Legjislativ–Gjuhësor, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që Projektligjet dhe të gjitha dokumentet e tjera, që i parashtron në Kuvendin e Republikës së Kosovës për shqyrtim, t'i përmbushin kriteret e hartimit në aspektin gjuhësor dhe të përdorimit të terminologjisë juridike të gjuhës serbe, përkatësisht përmbajtja e tekstit në gjuhën shqipe dhe serbe të jetë identike.
2. Ngarkohet sekretari i Kuvendit që të rishikojë dhe funksionalizojë Shërbimin e Gjuhësisë dhe atë të Njesisë për Standardizim Formalo - Juridik dhe Gjuhësor.

3.4 Njoftimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me vizitën studimore të realizuar në Slloveni

Kryesia e Kuvendit u njoftua me vizitën Komisionit për Buxhet dhe Financa, të realizuar në Parlamentin e Sllovenisë.

3.5 Njoftimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me vizitën studimore të realizuar në Gjermani

Kryesia e Kuvendit u njoftua me vizitën Komisionit për Buxhet dhe Financa, të realizuar në Parlamentin e Gjermanisë.

3.6 Kërkesa e deputetit Hydajet Hyseni për riprocedim të Projektligjit për ish të burgosurit politikë

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e deputetit Hydajet Hyseni për riprocedim të Projektligjit për ish të burgosurit politikë, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Projektligji për ish të burgosurit politikë t'u shpërndahet deputetëve.
2. Projektligji për ish të burgosurit politikë të radhitet për shqyrtim në mbledhjen e parë të sesionit vjeshtor.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:05 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Divizioni për çështje plenare dhe procedurale.